

AMNESTY INTERNATIONAL

DEKLARATË PUBLIKE

AI index: EUR 11/006/2010
20 maj 2010

Shqipëria: Të rinjtë që largohen nga përkujdesi social kanë nevojë për dinjitet dhe strehim – një apel në Ditën Kombëtare të Jetimëve

Në Ditën Kombëtare të Jetimëve në Shqipëri, Amnesty International u bën thirrje autoriteteve të sigurojnë që jetimët dhe të rinjtë e tjerë që rriten në strukturat e përkujdesit social të mos mbeten të pastrehë kur mbarojnë shkollën.

Strehimi social në Shqipëri është i pakët dhe përgjithësisht më të varfrit dhe të më të cenueshmit, përfshirë jetimët, nuk kanë akses në të. Po kështu, shumica e këtyre të rinjve nuk mund t'i përballojnë banesat private pa mbështetje financiare. Amnesty International u bën thirrje autoriteteve që pa vonesë t'u sigurojnë atyre akses në strehim të përshtatshëm, qoftë duke ua dhënë këtë mbështetje në formën e bonuseve të strehimit, qoftë me mjete të tjera.

Në raportin e nxjerrë sot, *Në kërkim të një strehe – Largimi nga përkujdesi social në Shqipëri (Indeks: EUR 11/004/2010)*, Amnesty International shkruan: "Varfëria është një prej arsyeve kryesore për vendosjen e fëmijëve në strukturat e përkujdesit social në Shqipëri, dhe shteti bën shumë pak për t'i ndihmuar ata të dalin nga varfëria". Si rezultat i mos-mbrojtjes së mjaftueshme të të drejtave të tyre nga shteti, kur mbushin moshën madhore, ata shpesh mbeten pa strehë dhe rrezikohen nga varfëria e skajshme dhe përjashtimi shoqëror.

E drejta për strehim të përshtatshëm garantohet në të drejtën ndërkombëtare, e cila kërkon nga shtetet t'u japin përparësi grupeve të pafavorizuara. Legjislacioni shqiptar u garanton jetimëve të drejtën e trajtimit me përparësi në strehim. Megjithatë, sipas statistikave zyrtare, në periudhën 1996-2008, vetëm 29 nga 845 persona me status jetimi kanë marrë banesë sipas dispozitave të këtij ligji (asnjë prej tyre pas vitit 2005). Politika e deritanishme e qeverisë për strehimin nuk i ka dhënë përparësi strehimit të njerëzve më në nevojë dhe nga programet aktuale të strehimit social do të përfitojnë vetëm një pakicë e vogël e të pastrehëve të Shqipërisë, që thuhet se janë gjithsej mbi 40 000 familje.

Amnesty International mendon se të rinjtë që largohen nga përkujdesi nuk marrin përkrahjen për të cilën kanë nevojë për të bërë kalimin në jetë të pavarur. Shumë prej tyre e mbarojnë shkollën pa marrë aftësitë dhe kualifikimet që do t'u mundësonin gjetjen e një punësimi të sigurt dhe të ardhura të mjaftueshme për të jetuar të pavarur.

Duke mos pasur një familje nga e cila mund të kërkojnë ndihmë, dhe shpesh në punë të pasigurta dhe të paguara keq, ata mund të kenë pak mundësi të tjera përveçse të jetojnë në kushtet e rënda të ndërtesave gjysmë të braktisura shkollë – e vetmja "zgjidhje" e shtetit për nevojat e tyre për strehim. Disa kanë rreth njëzet vjet që ndajnë dhoma në ndërtesa të tilla, dhe tani po rrisin edhe fëmijët në këto kushte të mjerueshme. Çdo vit, atyre iu shtohen të rinj të tjerë, që me mbarimin e shkollës, mbeten po ashtu të pastrehë.

Një e re, e rritur në strukturat e përkujdesit social, i tha kështu Amnesty International: "*Njeriu ka nevojë për më tepër se një copë bukë, ka nevojë të jetojë me dinjitet... Jetimi mund të ketë dinjitet vetëm nëse ka një shtëpi*".

Në raportin e vet, si edhe në një Memorandum dërguar qeverisë shqiptare në nëntor 2009 dhe bërë publik sot, *Jetimët dhe fëmijët e tjerë pa kujdes prindëror – shqetësimet e Amnesty International (Indeks: EUR 11/002/2010)*, organizata bën thirrje që të gjithë të rinjtë pa kujdes prindëror t'u jepet përkrahja dhe mbikëqyrja e duhur deri në moshën 18 vjeç, si dhe kur bëjnë kalimin në moshën e rritur dhe pavarësi. Përveç kësaj, ajo nxit qeverinë shqiptare të miratojë një legjislacion gjithëpërfshirës për largimin nga përkujdesi social, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ai duhet të përfshijë edhe të rinjtë e rritur në strukturat e përkujdesit social, që nuk i përmbushin kushtet për të marrë statusin e jetimit, por që familjet e tyre nuk janë në gjendje, ose nuk duan, t'u japin strehë dhe përkrahje.

Informacion shtesë

Kjo punë është pjesë e fushatës “Kërkojmë Dinjitet!” të Amnesty International që synon t'i japë fund dhunimeve të të drejtave të njeriut që shkaktojnë dhe thellojnë varfërinë në shkallë botërore. Fushata do të mobilizojë njerëz nga e gjithë bota për të kërkuar që qeveritë, korporatat, dhe të tjerë me pushtet, të dëgjojnë zërat e atyre që jetojnë në varfëri dhe të njohin dhe mbrojnë të drejtat e tyre. Për më tepër informacion shih <http://www.amnesty.org/en/demand-dignity>

FUND/